KARTA e TATIMPAGUESIT

Çfarë është Karta e Tatimpaguesit

Karta e Tatimpaguesit, është në fakt një “deklaratë”, në të cilën paraqiten të drejtat, por edhe detyrimet e tatimpaguesve.

Ky dokument nuk është një akt juridik në llojin e tij, por me anë të tij, bëhen publike të drejtat dhe detyrimet aktuale, të mirëpërcaktuara në bazën ligjore të të drejtave të njeriut në tërësi, si dhe të atyre të natyrës tatimore në veçanti. Në këtë mënyrë, publikimi i saj, kontribuon pozitivisht, në krijimin e një klime më të mirë të qytetarisë fiskale në vend.

Karta forcon më tepër, legjitimitetin e taksave e tatimeve në tërësi, por nga ana tjetër, ajo njeh dhe presumon vullnetin e mirë të tatimpaguesve, në përmbushjen e detyrimeve të tyre fiskale.

Ky dokument, i adresohet çdo tatimpaguesi, por edhe çdo zyrtari tatimor, për t'i paraprirë edhe çdo aksioni të vullnetshëm midis tyre, në dobi të respektimit të të drejtave dhe detyrimeve reciproke.

Arsye të ndryshme imponojnë hartimin e publikimin e Kartës së Tatimpaguesit, që nga prioritetet qeverisëse, përgjegjësitë e administratës fiskale, ndaj publikut të gjerë, promovimi i vlerave të barazisë dhe respektit të të drejtave të tatimpaguesve, përmirësimit të cilësisë së shërbimit nga i gjithë personeli i administratës.

Karta informon tatimpaguesit, jo vetëm për të drejtat që ato kanë, por edhe për detyrimet e tyre, sipas qasjes më optimale të mundshme.

Ajo siguron një informacion, mbi normat e shërbimit në dobi të tatimpaguesve, por mbi të gjitha, frymën e kooperimit e të pagimit të tatimeve, brenda afateve të parashikuara ligjërisht.

Karta ka karakter publik, duke përforcuar në këtë mënyrë besimin reciprok, midis administratës fiskale dhe tatimpaguesve.

Ajo krijon kushtet për një ndryshim, gjithnjë në përmirësim të të sjellurit, si nga njëra palë ashtu edhe nga pala tjetër.

TË DREJTAT
E TATIMPAGUESIT

E drejta e tatimpaguesit për t'u informuar

Çdo **tatimpagues** ka të drejtë, me qëllim kuptimin dhe zbatimin e legjislacionit tatimor, të marrë informacion nga administrata tatimore. Kjo asistencë, ju sigurohet në mënyrë të detyrueshme nga administrata tatimore, nëpërmjet **drejtorive të shërbimeve** për tatimpaguesit, të krijuara në çdo drejtori rajonale të tatimeve.

Por, ju mund të informoheni edhe nëpërmjet **informimit publik**, të detyrueshëm nga administrata tatimore, e cila ju vë në dispozicion, në rrugë elektronike, nëpërmjet medias së shkruar, fletë-palosjeve, publikimeve të ndryshme, legjislacionin tatimor, udhëzimet e dala në zbatim të tij, komentarët, urdhëresat dhe manualet tatimore.

E drejta e tatimpaguesit për t'u asistuar

Çdo tatimpagues ka të drejtë, të asistohet pa pagesë, për të njohur të drejtat, por edhe për të plotësuar detyrimet e tij, për situatat konkrete të tyre kontabël apo fiskale. Kjo asistencë ju sigurohet nga administrata tatimore nëpërmjet drejtorive të shërbimeve për tatimpaguesit, të krijuara në çdo drejtori rajonale të tatimeve.

Është detyrim për administratën tatimore, që të trajtojë në mënyrë të paanshme, profesionale dhe etike, çdo tatimpagues për çështje që kanë të bëjnë me detyrimet e tij tatimore, të dhënat e veta tatimore e financiare, të administruara nga administrata tatimore.

E drejta për konfidencialitetin e të dhënave

Administrata tatimore ju siguron dhe njëkohësisht është e detyruar, **të mbrojë konfidencialitetin** e të dhënave tuaja tatimore **personale** dhe financiare.

Bëhet fjalë për të **dhëna**, që i janë besuar asaj, apo që ajo ka mundur ti sigurojë në rrugë të ndryshme.

Këto të dhëna, përdoren nga **administrata tatimore** vetëm për qëllime të lejuara nga ligji dhe akses në to kanë vetëm punonjësit e administratës tatimore për qëllime të kryerjes së funksioneve të tyre ligjore.

Konsiderohen **konfidenciale**, të dhënat me natyrë tatimore dhe financiare që sigurohen nëpërmjet deklaratave të tatimpaguesve, kontrolleve tatimore të ushtruara, vlerësimeve tatimore të bëra, për këto tatimpagues dhe informacioneve të ardhura, ose të marra, nga persona të tretë, apo nga burime të tjera të ndryshme.

E drejta e tatimpaguesit për t'u njoftuar

Çdo tatimpagues ka të drejtë të **njoftohet në kohë** për çdo akt administrativ të administratës tatimore, të nxjerrë në emër të tij dhe që prek pasurinë apo detyrimet e tij tatimore. Gjithashtu, tatimpaguesi ka të drejtë, që të **njihet me arsyet**, por edhe bazën ligjore të nxjerrjes së aktit administrativ në adresë të tij.

Nga ana tjetër, administrata tatimore ka **detyrimin** të dërgojë në kohë çdo vendim administrativ të nxjerrë prej saj për tatimpaguesin, si dhe të japë bazën ligjore dhe çdo **shpjegim** tjetër të duhur, duke e informuar njëkohësisht tatimpaguesin edhe për të drejtat dhe detyrimet që lidhen me këtë vendim. Por, kjo e drejtë i humbet tatimpaguesit, kur administrata tatimore ka prova konkrete e të besueshme, se tatimi është në rrezik.

E drejta e Tatim Paguesit
për Informim

Çdo tatimpagues, i cili nuk është dakord me një vlerësim tatimor të administratës tatimore, ka të drejtë të marrë përgjigje me shkrim, për pretendimet e tij ndaj atij akti administrativ. Në përgjigje, administrata tatimore duhet të japë të gjitha arsyet e vlerësimit tatimor, mënyrën e vlerësimit që është përdorur, si dhe të drejtat e detyrimet e tatimpaguesit, lidhur me atë vlerësim. Gjithashtu, pas një kërkese me shkrim të tatimpaguesit, administrata tatimore është e detyruar që brenda një afati të shkurtër kohor, nga data e protokollimit të kërkesës në organin tatimor, të lëshojë dokumente (vërtetime) që konfirmojnë situatën tatimore të tatimpaguesit, lidhur me pagimin e detyrimeve tatimore, të ardhurat e tatueshme, detyrimet tatimore të papaguara, etj.

E drejta e tatimpaguesit për t'u **përfaqësuar**

Çdo tatimpagues ka të drejtë të emërojë përfaqësuesin e tij. Ky emërim bëhet me prokurë. Përfaqësuesi i tatimpaguesit, është një person që një tatimpagues e zgjedh, për ta përfaqësuar në lidhje me çështjet e tij tatimore. Përfaqësuesi i tatimpaguesit merr përsipër, të drejta dhe detyrime të tatimpaguesit dhe administrata tatimore, është e detyruar të bashkëpunojë dhe operojë me përfaqësuesin e tatimpaguesit, të caktuar prej tij.

Por, emërimi i një përfaqësuesi të tatimpaguesit, nuk e shkarkon këtë të fundit nga përgjegjësitë tatimore. Ai mbetet ligjërisht përgjegjës, për përmbushjen e detyrimeve tatimore të tij. Fakti që, përfaqësuesi i tatimpaguesit mund të bëjë një gabim, në deklarimin dhe pagesën e detyrimeve tatimore, nuk e shkarkon tatimpaguesin nga përgjegjësia për gabimin.



E drejta për të kërkuar **evidenca** me shkrim, apo në rrugë elektronike

Tatimpaguesi ka të drejtë, në çdo moment, t'i kërkojë administratës tatimore, **kopje elektronike** apo me **shkrim**, të njehsuar me origjinalin, të çdo dokumenti që ndodhet në dosjen e tij individuale. Përveç kësaj, ai ka të drejtë të kërkojë **kopje të printuara**, të të dhënave elektronike që lidhen me situatën e tij. Administrata tatimore, ka detyrim të sajin, krijimin dhe përditësimin e dosjes së **detyrimeve tatimore**, të tatimpaguesit, e cila duhet të jetë e **aksesueshme** në rrugë elektronike për tatimpaguesin. Në pamundësi, të aksesit elektronik, tatimpaguesi ka të drejtë t'i kërkojë me shkrim administratës tatimore që t'i vërë në dispozicion, kopje të dokumenteve të **dosjes së tij**.

E drejta për kontrolle të arsyeshme

Në rastin e një kontrolli tatimor të administratës tatimore, tatimpaguesi ka të drejtën, të njoftohet paraprakisht për kohën e fillimit të kontrollit, vendin ku ai do të kryhet, llojet e tatimeve që do të kontrollohen, periudhat tatimore që do të përfshijë kontrolli, etj. Tatimpaguesi ka të drejtë të trajtohet në mënyrë të sjellshme dhe të respektueshme, gjatë të gjithë kohës, përfshirë këtu periudhën kur i kërkohet informacion, kur intervistohet apo kur kontrollohet. Integriteti moral, profesionalizmi, respekti dhe kooperimi, janë vlerat kryesore të administratës tatimore, që duhet të shohë tatimpaguesi gjatë një kontrolli tatimor. Këto cilësi, duhet të manifestohen nga administrata tatimore, për të reflektuar përkushtimin e saj, për t'i dhënë tatimpaguesve shërbimin më të mirë të mundshëm.

E drejta e tatimpaguesit
për t'u **dëgjuar**

Përpara marrjes së një **vendimi ekzekutiv**, nga ana e administratës tatimore, tatimpaguesi ka të drejtë të presë nga kjo e fundit, që të **dëgjohet me vëmendje** për të dhënë sqarimet e nevojshme, për të parashtruar **pretendimet** që ka, për të shpjeguar rrethanat konkrete, etj.

Ai ka të drejtë gjithashtu, të sigurohet se shpjegimet dhe pretendimet e tij, do të **shqyrtohen** me vëmendje e ndershmëri nga administrata tatimore, në funksion të marrjes së **vendimeve të drejta** dhe në përshtatje me ligjet tatimore e aktet nënligjore.



E drejta e tatimpaguesit për t'u rikontrolluar

Pas kërkesës së tatimpaguesit, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, urdhëron për kryerjen e një **rikontrolli** tatimor, në rast se inspektori i tatimeve nuk ka vepruar në **përputhje me procedurat** dhe për këtë shkak, ndaj tij kanë filluar procedura disiplinore, apo janë marrë masa disiplinore.

Në përbërjen e grupit të rikontrollit tatimor, nuk mund të bëjnë pjesë **inspektorë**, që kanë marrë pjesë në kontrollin tatimor të **mëparshëm**.

E drejta e tatimpaguesit
për t'u **ankuar**

Në çdo rast, kur tatimpaguesi **nuk është dakord**, me një akt administrativ dhe beson se administrata tatimore, nuk e ka zbatuar në mënyrë korrekte ligjin, ai ka të drejtën e **ankimim-it** në Drejtorinë e Apelimit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përg-jithshme të Tatimeve.

Ai ka të drejtë, të kërkojë **rishqyrtimin** e pavarur ad-ministrativ të **çështjeve** që lidhen me këtë akt. Tatim-paguesi ka të drejtë gjithashtu, të ankohet në rrugë administrative në Drejtorinë Rajonale, apo në Dre-jtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për çdo **veprim** apo **mosveprim** të zyrtarëve tatimore, që mund të shkelin **të drejtat** e tatimpaguesit.

Nëse tatimpaguesi nuk do të jetë i **kënaqur** edhe nga vendimi i Drejtorisë se Apelimit, ai ka të drejtë të vazhdojë **ankimimin** e tij në Gjykatën Administrative.

E drejta e tatimpaguesit për t'u **mbrojtur** nga Avokati i Tatimpaguesve

Të drejtat e tatimpaguesve, në **marrëdhëniet** me **organet tatimore**, mbrohen nga **Avokati i Tatimpaguesve**.

Ju mund t'i drejtoheni kësaj zyre, për rastet e ankesave që kanë të bëjnë, me probleme të administrimit të tatimeve, si vonesa administrative të paarsyeshme, në zgjidhjen e problemeve e marrjen e **përgjigjeve**, gabime të zyrtarëve tatimorë, që nuk janë zgjidhur në mënyrën e duhur pas paraqitjes nga tatimpaguesi, mosrespektimi i **procedurave tatimore**, apo shkelje të procedurave tatimore nga zyrtarët tatimorë.

DETYRIMET E TATIMPAGUESIT

Një qëndrim qytetar ndaj **detyrimeve** tatimore

Çdo tatimpagues është i **detyruar** që:

Të bëhet i **identifikuar** nga administrata tatimore.

Të jetë i **informuar** dhe të **respektojë,** ligjshmërinë e detyrimeve tatimore dhe të kontrollit tatimor.

Të jetë i **kujdesshëm** në respektimin e kërkesave të ligjeve tatimore.

Të jetë i **informuar** për **avantazhet** që i siguron respektimi si dhe pasojat, që i sjell mos respektimi, i kërkesave të ligjeve tatimore.

Një qëndrim të sinqertë ndaj detyrimeve tatimore

Çdo tatimpagues është i detyruar që:

Të japë të dhëna të sinqerta e të sakta, brenda afateve të kërkuara.

Të nënshkruajë deklarata të sinqerta e të plota, pa asnjë fshehje apo mash-trim.

Të kërkojë gjithnjë zbritje e rimbur-sime, vetëm për vlera që i takojnë ligjërisht.

Të përgjigjet për çdo infor-macion, që i kërkohet nga administrata tatimore, në mënyrë të qartë e precize.

Të sqarojë me saktësi të gjithë rrethanat, të gjithë faktet dhe aktet, që ndikojnë në situatën e tij tatimore.



Një qëndrim **bashkëpunues** me administratën

Çdo tatimpagues është i **detyruar** që:

Të **bashkëpunojë** me punonjësit e administratës tatimore, me mirësjellje e respekt.

Të **paraqesë** në afatin e kërkuar **çdo të dhënë** të kërkuar nga administrata tatimore.

Të **lehtësojë**, hyrjen në **ambientet** e ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, në **përshtatje** me kushtet ligjore, të përcaktuara për këtë qëllim.

Të **sigurojë** dhe **pranojë**, korrespondencën,duke u vënë në dijeni në afatet e arsyeshme si dhe, të mos praktikojë arsye, që mund të krijojnë **vonesa**.

Të jetë i ndërgjegjshëm, për pasojat dhe t'i pranojë ato, në rastet e mosrespektimit të kërkesave, që lidhen me detyrimeve tatimore.

Korrektesë në dhënien e informacionit

Çdo tatimpagues është i detyruar që:

Të **nënshkruajë** deklarata, të hartojë dokumente për **qëllime tatimore** e t'i **dorëzojë** ato në afatin e kërkuar.

Të japë **informacion** të plotë e të **saktë**, në formë, në përmbajtje dhe afatin e përcaktuar.

Të **informojë** administratën tatimore, për çdo ndryshim të **situatës** së tij tatimore, që nga fillimi i veprimtarisë ekonomike, ndryshimin e **adresës**, ndryshimin e **veprimtarisë, mbylljen** e veprimtarisë, etj.

Korrektesë në **mbajtjen** dhe **ruajtjen** e dokumentacionit

Çdo tatimpagues është i detyruar që:

Të mbajë e të ruajë libra e **dokumente kontabël**, sipas kërkesave të përcaktuara ligjërisht dhe në përshtatje me afatet ligjore.

Të vërë në dispozicion të administratës tatimore, **libra**, **regjistra** e **dokumente kontabël**, në format material apo informatik, gjatë ushtrimit të **kontrollit tatimor**.

Të ruajë në afatet e përcaktuara në ligj, çdo dokumentacion, analizë, program informatik dhe nëse i kërkohet t'ia paraqesë **administratës tatimore**.

Korrektesë në **pagimin** e detyrimeve tatimore

Çdo tatimpagues është i detyruar që:

Të paguajë shumën e plotë të **detyrimeve** tatimore, brenda afateve të përcaktuara ligjërisht.

Të paguajë shumën e plotë të çdo **borxhi** tatimor, përfshirë dhe çdo **penalitet** të vendosur.

Të pranojë dhe **respektojë** një plan pagese të borxhit tatimor të menjëhershëm, ose të formës së pagesës me **këste**.

Të respektojë kriteret e mbajtjes në burim të tatimit dhe pagimin e tij, sipas **afateve ligjore**.

Vizioni

Vizioni i administratës shqiptare të tatimeve është ai i një organizate, e cila i përmbush standardet e administratave mbarë botën, si:

Një institucion, që ofron shërbime tatimore cilësore, që e rrit ndërgjegjësimin tatimor në shoqëri, nxit pajtueshmërinë vullnetare përmes pagimit të tatimeve dhe taksave, me idenë për ta ulur barrën administrative mbi tatimpaguesit dhe për ta thjeshtuar administrimin e tatim-taksave.

Një autoritet që i mbledh, inspekton dhe kontrollon me drejtësi detyrimet tatimore, duke zbatuar me forcë ligjin dhe duke luftuar ekonominë informale dhe evazionin, në mbrojtje të të ardhurave fiskale.

Një organizatë që respektohet nga shoqëria, që e ruan dhe e përshtat strukturën dhe vlerat e saj organizative përmes përshtatjes ndaj ndryshimeve ekonomike dhe sociale, duke përdorur mjetet dhe metodat e teknologjisë më të përparuar si edhe duke bashkëpunuar me shoqatat e biznesit dhe me shoqërinë civile, autoritetet tatimore të shteteve të tjera dhe me organizatat. Një agjenci publike, që e përmbush misionin e vet, duke e përmirësuar veten dhe duke e formuar personelin e saj në vazhdimësi.

Vlerat

Vlerat e forta e rrisin besimin dhe mbështetjen, që ka komuniteti i tatimpaguesve, për mënyrën se si e administrojmë sistemin tonë tatimor. Këto vlera mbështeten:

Te besimi i tatimpaguesve
E rrisim besimin e komunitetit të tatimpaguesve përmes rritjes së zotësive tona profesionale, përmes reagimit ndaj problemeve të tyre, përmes rritjes së transparencës ditë pas dite, përmes trajtimit me drejtësi, barazi dhe ndershmëri të tatimpaguesve, përmes ruajtjes së niveleve të larta të integritetit moral, si edhe përmes nxitjes së kulturës së respektit reciprok.

Te zbatimi i normave të etikës dhe të luftës kundër korrupsionit

E zbatojmë me forcë ligjin, sipas **standardeve etike** të administratës sonë, me tolerancë zero, kundër korrupsionit, sepse kjo mënyrë administrimi u jep tatimpaguesve garanci për drejtësinë dhe siguri. Për vetë veçoritë e sektorit tatimor, vënia në jetë e **Kodit të Etikës** së administratës tatimore, mbi të cilin është prezumuar betimi i kësaj administrate, për një nivel shërbimi në përshtatje me kërkesat më të mira të arritura, apo të pritshme për t'u arritur.

Te mbështetja te tatimpaguesit

Mbështetemi te tatimpaguesit, te kontributi i profesionistëve në fushën e financave dhe tatimeve, si dhe tek ndërmjetësit e tjerë të zbatimit të ligjit, të cilët kërkojnë të **veprojnë drejt**, duke punuar me ta, përmes konsultimeve e bashkëpunimit, si dhe duke u mbështetur te parimi i pajtueshmërisë vullnetare.

Te raportimi

Jemi **transparentë** në raportimin e aktiviteteve tona dhe në marrjen e **mendimeve të publikut**, për çështjet e menaxhimit të riskut. I dëgjojmë dhe reagojmë ndaj mendimeve të tatimpaguesve. Do të marrim hapa të mëtejshëm për t'i ndihmuar tatimpaguesit, të rrisin nivelin e njohurive dhe përmbushjes së detyrimeve ligjore, si edhe për të punuar drejt **uljes** së **kostove** administrative, për biznesin dhe për administratën tatimore.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISE

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
Rruga: Gjin Bue Shpata, Tiranë, 1000
www.tatime.gov.al
Telefon 04 22 76 840